



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-084

Prishtinë, më 20 nëntor 2012, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 20 NËNTOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Elmi Reçica, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 nëntor 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 12 nëntor 2012

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 12 nëntor 2012.

Nënkryetari i Kuvendit Sabri Hamiti e pati një vërejtje në transkript, përkatësisht në faqen 5, në të cilën është evidentuar gabimisht togfjalëshi “Ministria e Drejtësisë” në vend “Ministria e Shëndetësisë”. Transkripti është korrigjuar sipas kësaj vërejtjeje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, e plotësoi rendin e ditës për mbledhjen plenare, e cila do t'i vazhdojë punimet më 22 nëntor 2012 edhe me dy pika shtesë:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor,
2. Shqyrtimi i Raportit të tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2012.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Projektligjin e cekur më lart, e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i hartuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision Funksional, që ta përgatisë raportin preliminar për shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet.

2. Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozim-vendimin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision Funksional, që ta shqyrtojë propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kryesisë së Kuvendit për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

3. Raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me raportin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojnë Raportin vjetor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011 dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2012

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmuajorin e vitit 2012, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

Pikat shitesë:

1. Kërkesa e Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës dhe kompensimit për anëtarët e institucioneve dhe të agjencive të pavarura

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që me rastin e shqyrtimit të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 t'i shqyrtojë mundësitë buxhetore dhe Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesë propozim-vendimin për caktimin e pagës dhe kompensimin e anëtarëve të institucioneve dhe agjencive të paravera, derisa të miratohet Ligji për pagat e funksionarëve të lartë publikë.

2. Kërkesa e Grupit të Grave Deputete për ndihmë financiare për blerjen e aparaturës së Mamografit Mobil

Kryesia, pasi e rishqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa në shumën prej 2 000 (dymijë) euro, sipas kërkesës së Grupit të Grave Deputete për blerjen e aparaturës së Mamografit Mobil.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta zbatojë këtë vendim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale